



Të dashur prindër,

me këtë shkresë ne dëshirojmë që juve si familje dhe në veçanëti fëmijës tuaj t'i urojmë mirëseardhje të përzemërt në çerdhe. Vendi në çerdhe paraqet një mundësi të madhe për fëmijët tuaj, për t'u vendosur në Gjermani. Këtu ai mund të përjetojë pak normalitet, të bëjë përvoja pozitive, të luaj me fëmijë të tjerë dhe të mësojë shumëçka tjetër. Ndër të tjera, edhe gjuhën gjermane. Fëmijët në këtë moshë i mësojnë këto gjëra shumë shpejtë, duke qenë mes moshatarëve.

E drejta për një vend në çerdhe dhe lirimi nga pagesa e kontributeve

Në Gjermani secili fëmijë që i ka mbushur një vjet, ka të drejtë për një vend të përkujdesjes ditore në çerdhe. Posa t'i mbush dy vjet, kjo përkujdesje ditore në çerdhet në Rheinland-Pfalz prindërve iu ofrohet falas. Në çerdhe ka të ashtuquajtura vende për përkujdesje gjysmëditore dhe për përkujdesje gjithëditore. Në rastin e përkujdesjes gjysmëditore fëmijët mund të jenë në çerdhe paradite dhe pas një pauzeje të drekës, të vijë përsëri pasdite. Në rastin e përkujdesjes gjithëditore fëmijët mund të jenë në çerdhe tërë ditën pa ndërprerë dhe aty të marrin edhe një shujtë të drekës.

Detyra e një çerdheje dhe ambientimi

Çerdhet e kanë për detyrë edukimin, arsimin dhe përkujdesjen. Ato i obligohen mirëqenies së fëmijës. Qëllimi është që fëmijët të edukohen si personalitete që marrin përgjegjësi për veprimet e tyre dhe kanë kompetencë sociale, si dhe zgjimi i interesimit dhe kureshtjes së tyre për botën. Për këtë qëllim p.sh. ambientet rregullohen ashtu, që fëmijët të përdorin dhe provojnë vetë materialet e lojës. Edukatorët dhe edukatorët e përcjellin poashtu se për çfarë interesohet fëmija juaj në veçanëti dhe mundohen t'i ofrojnë atij pikërisht atë. Njëkohësisht fëmija juaj e ka mundësinë të luaj me fëmijët e tjerë dhe të mësojë nga dhe me ta.

Në mënyrë që fëmija juaj të ndihet mirë, është e rëndësishme që ai të mund të krijojë marrëdhënie mirëbesimi me edukatorët dhe edukatorët. Për këtë arsye fëmija juaj do të ambientohet ngadalë. Prindërit shkojnë në ditët dhe javët e para me të në çerdhe. Koha, të cilën fëmija e kalon pa prindërit në çerdhe shtohet gradualisht, deri sa fëmija në fund të jetë në gjendje të qëndrojë vetë në çerdhe. Kjo zgjatë afërsisht katër javë. Këtë çështje ju e diskutoni në mënyrë të hollësishme me edukatorët dhe edukatorët.

Partneriteti i arsimin dhe edukimit

Ju si prindër për çerdhen jeni një partner shumë i rëndësishëm, sepse ju e njihni fëmijën tuaj më së miri. Ju e dini p.sh. çfarë ai ha me qejf, si qetësohet dhe cilën lojë e luan me qejf. Çerdhet dëshirojnë të bashkëpunojnë me ju si prindër. Ka forma nga më të ndryshmet të bashkëpunimit: bisedat në kohën kur e merrni, apo e sillni fëmijën në çerdhe, bisedat me prindër në termine të caktuara, mbrëmjet prindërore, takimet prindërore në kafene, etj.

Baza e bashkëpunimit më së shpeshti rregullohet me anë të një kontrate të edukimit, të cilën ju e lidhni me bartësin¹ e çerddes. Lidhur me këtë ju do të informoheni më hollësisht nga çerdhja.

¹ Bartës të një çerdhe në përgjithsi janë komunat, Kisha evangjeliste, ose katolike, gjegjësisht iniciativat e prindërve.



Ju lutemi bëni pyetje rreth punës pedagogjike në çerdhe dhe tregoni çfarë juve ju duket e rëndësishme për edukimin e fëmijës tuaj. Idetë e edukimit duhet të diskutohen.

Mundohuni për fillim që së bashku me çerdhen të shfrytëzoni mundësitë e përkthimit të ofruara nga të tjerët, në mënyrë për t'u kuptuar me edukatorët dhe edukatorët. Shfrytëzoni mundësinë e bashkëpunimit. Kjo ju ndihmon edhe juve për të krijuar dhe mbajtur kontakte me çerdhen.

Arsimi fetar

Në çerdhe takohen fëmijë dhe të rritur me origjinë shoqërore, nacionalitet, kulturë dhe besime të ndryshme. Arsimi fetar është temë në të gjitha çerdhet. Në Rheinland-Pfalz krahas bartësve komunalë dhe iniciativave të prindërve, ka edhe bartës konfesionalë të çerdheve, p.sh. kishat evangjeliste dhe katolike. Përditshmëria këtu është e karakterizuar nga besimi i krishterë. Ju dhe fëmija juaj jeni përziemërsisht të mirëseardhur në këto institucione me besimin dhe fenë tuaj. Informohuni më së miri që gjatë regjistrimit të fëmijës tuaj rreth asaj se si zhvillohet dhe përjetohet arsimi dhe edukimi fetar në çerdhe.

Gjuha e origjinës, arsimi gjuhësor dhe nxitja e gjuhës

Nëpërmjet gjuhës njerëzit mund të ndërtojnë marrëdhënie me botën që i rrethon dhe ta kuptojnë atë. Për këtë arsye është shumë e rëndësishme për fëmijën tuaj që ai të mësojë gjuhën gjermane. Për dallim nga ne të rriturit, fëmijët e mësojnë një gjuhë të huaj fillimisht shumë shpejtë. Duke qenë mes fëmijëve moshatarë në çerdhe, fëmija juaj do t'ia dalë mirë mbanë. Për këtë është e rëndësishme që ai të mund të jetë edhe krenar me gjuhën e tij të origjinës. Ju lutemi që me fëmijën tuaj në shtëpi të flisni edhe më tej gjuhën tuaj amëtare! Vetëm kur fëmija mund t'a flasë mirë gjuhën e tij dhe kur kjo të pranohet nga rrethi, ai në mënyrë të relaksuar dhe me kureshtje i qaset mësimin të një gjuhe tjetër. Edukatorët dhe edukatorët e dinë këtë dhe do t'a ndihmojnë fëmijën tuaj për të arritur atë.

Në shumë çerdhe me pjesëmarrje të lartë të fëmijëve me origjinë migrimi ky proces ndihmohet nëpërmjet masave shtesë gjuhësore dhe nëpërmjet të ashtuquajturve ekspertë për çështje ndërkulturore. Një pjesë e këtyre vetë kanë origjinë migrimi dhe në bazë të përvojës së madhe e dinë se çfarë do të thotë, të duhet të gjendesh në një botë të huaj.

Çerdhja si vend për shërbime dhe oferta të tjera mbështetëse

Në Gjermani ka një numër të madh të shërbimeve mbështetëse për familjet e reja. Çerdhet shpeshëherë kanë një rrjet të mirë në qytet dhe dinë për ofertat e tjera, të cilat mund t'i shfrytëzoni ju si familje. Mirëpo edhe prindërit e tjerë e dinë çfarë ofrohet në qytet, p.sh. në qendrat këshilluese, kurset gjuhësore për ju si prindër, ofertat e shoqatave. Ju lutemi shfrytëzoni mundësitë ekzistuese për të mësuar gjuhën gjermane, në mënyrë që të mund të orientoheni më mirë në Gjermani. Ka një numër të madh të shoqatave p.sh. në fushën e sportit, nëpërmjet të cilave ju dhe familja juaj mund të vendosni kontakte. Mirëpo mund të gjendet edhe mbështetje në çështjet rreth edukimit dhe në ballafaqimin me përvojat e rënda, p.sh. për shkak të ikjes dhe dëbimit. Mos u dekurajoni. Pyetni dhe kërkoni kontaktin me edukatorët dhe edukatorët, si dhe me prindërit e tjerë. Ia vlenë!

Ju dëshirojmë gjithë të mirat e mundshme për jetën tuaj në Gjermani!